

Fjalim i deputetes Andia Ulliri

13.07.2023

– Të nderuar kolegë,

Së pari, dua të shtoj se jam dakord me parafolësin për çështjen që ngriti, duke treguar se, kur bëhet fjalë për mënyrën se si ne i shkruajmë ligjet, duhet të jemi të kujdesshëm, që të mos cenojmë të drejtat dhe të mos jemi diskriminues, pavarësisht se projektligji që vjen sot është i një rëndësie të veçantë, i cili duhet marrë dhe zbatuar me përpikëri.

Dua të marr vëmendjen tuaj për një nga shqetësimet dhe ngjarjet që ka ndodhur javën e kaluar, për të cilën ka pasur një impakt të gjerë. Përfundimi i sesionit parlamentar shoqërohet me raporte të shumta dhe seanca të gjata, ku shpeshherë jemi të detyruar të flasim më shumë për çështje të ndryshme, duke bërë që të bjerë fokusi për disa shqetësime.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj një shqetësim: sigurinë në det. Do të marr vetëm pak minuta kohë, duke dalë nga rendi i ditës, për të sjellë një shqetësim që ma kanë përcjellë shumë qytetarë. Si fillim, dua t'u kërkoj ndjesë dhe t'u shpreh ngushëllimet e mia dhe të kolegëve të mi të gjithë familjarëve të viktimave, për të cilët do të diskutoj, për tragjedinë e datës 9 korrik në Kavajë, ku humbën jetën 3 persona! Prej vitesh një shqetësim i madh mbetet mungesa e sigurisë në vijën bregdetare, por këtu nuk dua të flas për çmimet abuzive apo për faktin se ligji përcakton që çdo subjekt duhet të garantojë 20% e plazhit të jetë publik, kriter që nuk është zbatuar asnjëherë, siç edhe e kemi dëshmuar, por në nenin 5 të VKM-së nr. 171, datë 27.03.2019, ndryshuar në vitin 2022, bazuar në ligjin "Për turizmin", në pikën 8, shpjegohet se çdo subjekt i interesuar duhet të paraqesë një marrëveshje paraprake me vrojtues plazhi, e cila garanton sigurinë në stacionin e plazhit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Këtu lind pyetja: a u zbatua pika 8 e kësaj VKM-je, e ligjit tonë, në të cilën thuhet se vrojtuesi i plazhit duhet të ishte dhe të kishte dhënë sinjalizime dhe kufizime për hapësirën ujore në momentin kur tragjedia u mori jetën 3 qytetarëve shqiptarë? Gjithashtu, a u zbatua ligji, që për çdo stacion plazhi duhet të garantohet shërbimi me vrojtues plazhi çdo ditë, për çdo 80 metra vijë lineare bregdetare në hapësirë publike ose jo? Në nenin 14, pika 13, shpjegohet se, në rastin e shkeljes së zbatimit të kushteve të kontratës së lidhur, inspektorati përgjegjës për turizmin merr masa administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin, deri në zgjidhjen e kontratës.

Thënë këto, dua të shtroj disa pyetje.

A kishte roje bregdetare në ditën kur ndodhi ngjarja fatkeqe?

A monitorohen apo zbatohen ligjet që garantojnë sigurinë në det?

Pse nuk kanë reaguar institucionet dhe ministrinë përkatëse deri më sot?

A kemi ne kapacitetet e nevojshme për garantimin e këtij ligji, kur duhet të kemi vrojtues plazhi në çdo 80 metra të vijës bregdetare në hapësira publike ose jo?

Sa asistohen subjektet përkatëse në sigurimin e vrojtuesve të plazhit?

Të nderuar kolegë,
Të nderuar qytetarë,

Pse asnjëherë nuk flitet apo nuk merret asnjë përgjegjësi, edhe pse prej vitesh ndodhin ngjarje të tilla? Sepse qeveria ka treguar dhe faktuar se është e papërgjegjshme dhe e painteresuar në vendosjen e standardeve. Po të flasim për standardet që janë vendosur në çdo vend tjetër të rajonit apo të Europës, do të shohim se ka ligje që zbatohen dhe kritere të përcaktuara, të cilat vijnë në ndihmë, që këto situata të evitohen. Patjetër, ne duhet të bëjmë çfarëdolloj gjëje që kemi në dorë. Edhe personat që kanë përgjegjësi për zbatimin e ligjit duhet të jenë në lartësinë e detyrës së tyre, duhet të marrin përgjegjësinë që u takon për t'i vendosur këto standarde dhe për t'u siguruar se ligji zbatohet kudo njësoj, sepse standardi i sotëm nuk flet për mbrojtje jete apo për forcimin dhe garantimin e sigurisë publike.

Pavarësisht se karriget pas meje janë bosh, shpresoj që personat përgjegjës të ngrihen në lartësinë e detyrës që u është besuar dhe të garantojnë zbatimin e ligjit, sepse sot diskutohet për jetë të humbura dhe për rrezikun e përsëritjes së kësaj ngjarjeje edhe në vijim të sezonit.

Duke ju falënderuar për vëmendjen për këtë çështje, dua të kaloj edhe te pika 9 e rendit të ditës, te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, në lidhje me një hua koncesionale për programin “Përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore, pas tërmetit të vitit 2019””.

Në fillim të fjalës sime, dua të përmend se, në dy vjetët e fundit, prej momentit kur kam marr detyrën time, sa herë kemi diskutuar me zgjedhësit, kjo çështje ka qenë një nga kryefjalët e diskutimeve. Kjo për faktin se prej vitesh në shumë zona të njësisë Fushë-Krujë ka pasur ndërprerje të vazhdueshme të energjisë elektrike, ka pasur probleme në rrjetin shpërndarës, madje në pjesën më të madhe ka pasur furnizim me tension të ulët dhe për këto probleme asnjëherë nuk ka pasur asistim.

Dua ta falënderoj ministren, e cila në fjalën e saj tha se Fusha-Kruja ishte bashki!

E nderuar zonja Ministre, ka disa vite që Fushë-Kruja nuk është bashki, por është njësi administrative dhe si e tillë është trajtuar në investimet që ka marrë. Si pasojë e këtyre problematikave të gjithë banorët do t'i mirëpresin krahëhapur investime të tilla, duke shpresuar dhe besuar se do të ketë një zbatim të ligjit me përpikëri, ku të gjitha investimet të shkojnë në vendin ku u takon dhe të respektohen të gjitha kriteret. Në një njësi me shumë problematika infrastrukturore dhe pa investime serioze nga pushteti vendor dhe qendror, duhet të merret parasysh fakti se fshati Qerekë, në njësinë Nikël, është një nga zonat që lidhet ngushtë me zonën e aeroportit dhe prej vitesh përballat me ndërprerje të energjisë elektrike dhe tension të ulët, gjë që ka dëmtuar familjet dhe bizneset e kësaj zone. Diskutimi im për këtë çështje konsiston në faktin se rrjeti shpërndarës lidhet me nënstacionin e Valiasit të Bashkisë së Kamzës, pavarësisht se fshati ndodhet në njësinë administrative Nikël, e cila ndodhet në Bashkinë e Krujës. Çfarë ndodh me këta banorë? A e marrin këta ata përfitimin nga ky investim, duke qenë se janë banorë të njësisë administrative Nikël, por në të vërtetë nënstacioni i tyre nuk ndodhet në zonën e Bashkisë së Krujës? Çfarë ndodh me këta banorë, të cilët presin prej vitesh ndërhyrje në rrjet?

Po ashtu, zona e Bubqit është njëra nga njësitë që është përballur me vështirësitë e ndërprerjes së energjisë elektrike ndër vite, shoqëruar nga një rrjet i amortizuar dhe tension i ulët. Sidomos nëse do të shkojmë në zonat më malore të asaj zone, do të shikojmë që rrjeti shpërndarës konsiston në disa shkopinjtë druri të periudhës komuniste, pasi edhe sot e kësaj dite nuk ka pasur asnjë ndërhyrje në rrjet.

Të nderuar kolegë,

Investime të tilla janë themelore për të garantuar të drejtat kushtetuese të qytetarëve tanë. Investime të tilla janë të vonuara. Këto investime duhet të vendosin një standard të ri jo vetëm për rrjetin e shpërndarjes, por, siç e thashë, për garantimin e të drejtave kushtetuese të qytetarëve tanë.

Nuk dua të përmend këtu se çfarë ka ndodhur apo si ka reaguar qeveria në rastet kur ka pasur pagesa të vonuara dhe kamatëvonesa. Nuk dua të përmend jetët e humbura, njerëz të cilët janë hedhur nga ballkonet e spitaleve, sepse nuk paguanin dot faturat e tyre. Sot dua të flas për një standard të ri që ne duhet të vendosim për energjinë elektrike. Sa diskutojmë ne për përmirësimin e standardit të jetesës në vendin tonë? Sa nga ju e dini se çfarë do të thotë sot “varfëri energjetike”? Shqipëria është një nga vendet me impaktin më të gjerë të varfërisë energjetike në rajon, pasi ne jemi një nga vendet që ende po kalon periudhën e tranzicionit dhe ende nuk po rikuperohejmë nga ky tranzicion. Ne kemi banorë që nuk kanë asnjë mbështetje për problematikën energjetike.

Së fundi, uroj që kjo marrëveshje të zbatohet me transparencë dhe përpikëri! Uroj që shuma prej 35 milionë eurosh të vihet në dispozicion të të gjithë këtyre banorëve të qarkqeve Durrës, Lezhë dhe Shkodër, sepse këto janë 3 zona që nuk kanë përfituar investime, qoftë në infrastrukturë, qoftë në infrastrukturën energjetike, por janë edhe disa prej zonave më të privuara nga qeveria ndër vite.

Dua të sjell në vëmendje edhe rastin e rrugës Thumanë-Kashar, e cila trumbetohet si një nga investimet më serioze. Çfarë ndodhi me atë rrugë? A ka pyetur ndonjëri prej jush se çfarë do të ndodhë me shtyllat e tensionit të lartë që janë anës rrugës? Sa do të kushtojë largimi i këtyre shtyllave nga rruga, duke qenë se gjurma e rrugës u ndryshua për të tretën herë, për disa arsye që ne nuk i dimë edhe sot, sepse nuk ka transparencë?

Prandaj, të nderuar kolegë, uroj që ky ligj të jetë fillesa e vendosjes së një standardi të ri, ku transparenca të jetë kryefjala e këtij projektligji, dhe që korrupsioni të mos e prekë këtë projektligj si shumë projektligje të tjera!

Faleminderit!